



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA
(ADISA)

RAPORT MONITORIMI PËR ZBATIMIN E PROCESIT BUXHETOR

Periudha e raportimit: Janar – Dhjetor 2017

Në zbatim të Ligjit nr. 130/2016 datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, Akt Normativ Nr. 3, datë 6.11.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar; Udhëzimit Nr. 2/2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” (të ndryshuar) dhe Udhëzimit nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit për njësitë e Qeverisjes Qendrore”, Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) ka vijuar me kryerjen e shpenzimeve buxhetore brenda programit të vetëm buxhetor me emërtesën:

- **“Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike”** ku përfshihet buxheti i miratuar dhe akorduar për vitin buxhetor 2017, i ndarë sipas artikujve ekonomikë vijues:

Fondi i Pagave:	101,107 mijë lekë (zëri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	21,673 mijë lekë (zëri 601)
Fondi për Shpenzime Operative:	20,000 mijë lekë (zëri 602)
Fondi i Investimeve të brendshme:	82,442.2 mijë lekë (zëri 230) (Financim FZHR) 62,700 mijë lekë (zëri 231)
Fondi i Investimeve të huaja:	70,000 mijë lekë (zëri 230) (financim i IBRD) 60,000 mijë lekë (zëri 231) (financim i IBRD)

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zërat 600+601) janë realizuar në zbatim të strukturës të miratuar me VKM nr. 654 datë 14.09.2016 deri në muajin Mars 2017 të ndryshuar me VKM nr. 306 datë 05.04.2017 nga muaji Prill e në vazhdim. Shumat e realizuara për periudhën e raportimit janë përkatësisht 85,025 mijë lekë për artikullin 600 dhe 14,036 mijë lekë për artikullin 601, që përkthehen në 81 % të totalit të buxhetuar. Ky realizim vjen si rezultat i numrit faktit të të punësuarve gjatë periudhës së raportimit si dhe pagesave respektive.

Numri faktik i punonjësve të punësuar në fund të muajit Dhjetor 2017 është 139 persona. Brenda këtij numri janë përfshirë dhe 4 punonjëse me leje lindje të cilat marrin pagesë nga sigurimet shoqërore. Gjatë kësaj periudhe janë punësuar si personel me kohë të plotë 67 punonjës. Të larguar nga puna gjatë, kësaj periudhe kanë qenë 19 punonjës.

Fondi për shpenzime në mallra dhe shërbime (zëri 602), është realizuar në vlerën 18,241 mijë lekë ose 91% të totalit. Kjo masë realizimi konsiderohet si realizim shumë i mirë. Fondi i realizuar përfshin pagesat për procedurat e prokurimit për blerje “Blerje rulon termik”, “Blerje bojë printeri (20% shtesë kontrate)”, “Dietat brenda vendit”, “Blerje karburant”, “Shpenzime energji elektrike”, “Shërbim roje private”, “Shpërblim i Këshillit Drejtues”, “Shërbim postar”, “Shërbim telefoni”, “Shërbim mirëmbajtje automjeti”, “Siguracion automjeti”, “Shërbim mirëmbajtje ashensori”, “Shërbim qira salle”, “Shërbim pritje përcjellje”, Shpenzime për ujësjellës kanalizime”, “Taksa bashkie”, “FV Pjesë këmbimi për fotokopje dhe printer”, etj.

Fondi për Investime të brendshme (zërat 230+231), është i detajuar:

1. Konsulencë për ri-inxhinierimin e shërbimeve publike në shumën 82,440.960 mijë lekë (zëri 230) (Financim FZHR). Realizimi në pagesa për vitin 2017 është në masën 100%.

Këto fonde janë mbartur nga vitit i kaluar, pasi janë akorduar në bazë të Vendimit Nr. 29 datë 29.05.2015 të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve (KZHR). Fondet e papërdorura nga fondi për konsulencë ri-inxhinierimi (82,440.960 mijë) janë mbartur në vitin 2017, mbështetur në amendimin e kontratës përkatëse.

2. Rikonstruksioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Krujë (shtesë kontrate) në shumën 3,600 mijë lekë. Vlera e kontraktuar ishte 3,600 mijë lekë dhe realizimi i saj në periudhën Janar – Dhjetor 2017 është 100%. Kjo kontratë është likuiduar në fillim të muajit Qershor 2017.

3. Mbikëqyrje punimesh shtesë objekti: Rikonstruksion i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Krujë në shumën 64 mijë lekë. Vlera e kontraktuar është 63.96 mijë lekë. Kjo kontratë është e realizuar në masën 100% dhe është likuiduar në muajin Qershor 2017.
4. Kolaudim punimesh shtesë objekti: Rikonstruksion i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Krujë në shumën 36 mijë lekë. Vlera e kontraktuar është 7.8 mijë lekë. Kjo kontratë është realizuar në masën 100%. Madje nga ky fond është proceduar edhe me pagesën e kontratës me të njëjtin objekt për vitin 2016.
5. Rikonstruksioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Gjirokastrë në shumën 53,800 mijë lekë. Vlera e kontraktuar është 50,621 mijë lekë. Kjo kontratë është e realizuar në masën 100%.
6. Mbikëqyrje punimesh objekti: Rikonstruksion i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Gjirokastrë në shumën 960 mijë lekë. Vlera e kontraktuar është 923 mijë lekë. Kjo kontratë është e realizuar në masën 100% dhe likuidimi i saj është realizuar në muajin Dhjetor.
7. Kolaudim punimesh objekti: Rikonstruksion i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Gjirokastrë në shumën 96 mijë lekë. Vlera e kontraktuar është 91 mijë lekë. Kjo kontratë është e realizuar në masën 100% dhe likuidimi i saj është realizuar në muajin Dhjetor.
8. Garanci punimesh Rikonstruksioni i Qendrës së Integruar Shërbimeve Publike Krujë në vlerën 948 mijë lekë. Për shkak të ndryshimit të kodit të Institucionit me Akt normativ nr. 3 dt. 06.11.2017 nga grupi 03 në grupin 87.
9. Blerje pajisjesh TIK në shumën 2,100 mijë lekë. Janë lidhur kontratat respektive. Është lëvruar produkti dhe pranuar fatura por nuk është kryer pagesa për shkak të mbylljes së veprimeve në degën e Thesarit për datën 29.12.2017.
10. Blerje pajisje Zyre në shumën 96 mijë lekë. Vlera e kontraktuar është 95.988 mijë lekë. Masa e realizimit është 100%.
11. Blerje Zyra Lëvizëse ADISA në vlerën 30,300 mijë lekë. Vlera është zvogëluar në 1,000 mijë lekë për shkak të pezullimit të procedurave të prokurimit me VKM 482 dt. 05.07.2017 "Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit për vitin 2017"

Fondi për Investime të huaja (zërat 230+231), është miratuar në shumën 70,000 mijë lekë në zërin 230 dhe 60,000 mijë lekë në zërin 231. Financimi i huaj është i detajuar sipas regjistrit të prokurimeve të miratuar nga Banka Botërore. Nga ky fond janë realizuar 1,191,551.59 euro ose 159,667.9 mijë lekë. Në përqindje realizimi i financimit të huaj është në masën 123%.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2017, të parashikuara në PBA 2018-2020, janë si më poshtë:

1. Ngritja dhe menaxhimi i më shumë se 5 Qendrave të Integruara për Ofrimin e Shërbimeve administrative (Rikonstruksioni i Qendrave të Integruara në më shumë se 5 qytete); Ngritja dhe administrimi i sporteve fizike (FO).
2. Përfundimi i procesit të ri-inxhinierimit të shërbimeve publike. Miratimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe adaptimit të teknologjisë.
3. Hartimi i standardeve për ofrimin e shërbimeve publike në sporte, në bazë të modelit të kujdesit për klientin.
4. Matja e performancës së zyrave pritëse.
5. Ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale.
6. Përcaktimi dhe zhvillimi i kanaleve të informimit të qytetarëve mbi shërbimet publike.
7. Përcaktimi i rregullave për hartimin e modeleve të shërbimeve publike dhe të kodifikimi të tyre.
8. Fushatë ndërgjegjësimi për reformën e shërbimeve publike.

Realizimi i këtyre objektivave nënkupton, në mënyrë të drejtpërdrejtë, realizimin e aktiviteteve dhe produkteve të argumentuara si më poshtë.


Realizimi i Produkteve:

Për produktet e paraqitura në PBA 2018-2020, verifikohet një ecure mirë e realizimit të tyre referuar kontratave respektive.

Error! Not a valid link.

Në vijim paraqitja grafike me përqindjen e realizimit të produkteve:

% e Realizimit të produkteve



Më poshtë po ju paraqesim një argumentim të shkurtër të vlerave të realizimit të vendosura nga ana jonë, si më poshtë:

Produktin A: Realizimi është vendosur 100% sepse është marrë nën administrim sporteli i ZVRPP Tiranë, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore. ADISA aktualisht lëvront të gjitha shërbimet e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (51 shërbime nga 51 shërbime në total), dega Tiranë.

Produkti B: Realizimi është vendosur 100% sepse për periudhën e raportimit janë funksionale të 4 Qendra e Integruar e Shërbimeve Publike nga 4 të planifikuara për vitin 2017.

Qendra e Integruar e Shërbimeve Publike në qytetin e Kavajës është funksionale që prej muajit Tetor 2016.

Qendra e Integruar e Shërbimeve Publike në qytetin e Krujës është funksionale që prej muajit Mars 2017.

Qendra e Integruar e Shërbimeve Publike në qytetin e Fierit është funksionale nga muaji Maj 2017.

Qendra e Integruar e Shërbimeve Publike në qytetin e Gjirokastrës është funksionale që prej muajit Qershor 2017

Produkti C: Ky produkt lidhet direkt me kontratën me objekt “Procesi i ri-inxhinierimit për Qendrën e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara”.

Kjo kontratë është përfunduar dhe likuiduar në masën 100%. Nga operatori ekonomik Deloitte Albania sh.p.k janë dorëzuar të gjitha produktet e kontratës. Në përfundim të projektit janë dhënë rekomandime për: 382 procese aplikimi/trajtimi të përmirësuar për 10 institucionet në fokus, eliminimin e 91

dokumenteve dhe integrimin e 182 dokumenteve. Gjithashtu nga konsulentit janë përpiluar rekomandime për të gjitha sistemet TIK, në raporte individuale për çdo institucion ku u përfshin iniciativat në nivel institucioni, të cilat konsistuan në:

- Implementime sistemesh të teknologjisë së informacionit;
- Automatizim hallkash në nivel shërbimi;
- Integrimi midis sistemeve të teknologjisë së informacionit në nivel institucioni ose institucionesh;
- Dixhitalizim/indeksim/integrim informacionesh që ndodheshin në format jo dixhital, të pa indeksuara, ose të pa integruara;
- Përmiresime të funksionaliteve të sistemeve TIK;
- Implementimi i metodave inovative për kryerjen e pagesave online;
- Shtimi i kanaleve të aplikimit nëpërmjet portalit qeveritar “e-albania”;
- Perdorimi i certifikatave dixhitale si pjesë e lëvrimit të shërbimeve;
- Optimizimin e performancës së sistemeve të informacionit.

Produkti D: Ky produkt ka përfunduar me realizimin e kontratës së lidhur me Deloitte Albania. Kompania në fjalë ka punuar dhe ka dorëzuar në ADISA raportin për aktet ligjore. Për vënien në zbatim të ri-inxhinierimit të shërbimeve për 10 Institucionet në objekt janë propozuar ndryshime për 65 projektakte, përkatësisht: 2 projektligje, 29 Projektvendime, 13 Urdhëra Ministri, 13 Udhëzime dhe 8 Rregullore, të cilat janë dakordësuar me institucionet.

Produkti E: Janë miratuar standardet për: formularët e aplikimit; kartela informative e shërbimeve dhe karta e qytetarit. Karta e Qytetarit është shpërndarë në 18 Institucione dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje apo sugjerim për ndryshim të saj.

Aktualisht ADISA ka standardizuar 128 formularë dhe ka përpiluar 565 kartela informative ku 509 kartela janë të standardizuara (të konfirmuara nga institucionet).

Formularët e aplikimit dhe kartelat informative janë në proces përditësimi për disa institucione në fokus. Ndërkohe ka nisur bashkëpunimi për konfirmimin e kartelave për institucionet out of scope.

Produkti F: Ky produkt është i lidhur ngushtësisht me kontratën me objekt “Development of the citizen Feedback Mechanism System (CFM)” për ndërtimin e sistemit për matjen e opinionit të qytetarëve. Kjo kontratë është e realizuar në masën 100%.

Gjithashtu Sektori i Performancës ka realizuar:

1. Sondazhe Online çdo muaj për Zyrën Vendore Kavajë dhe Zyrën Rajonale Tiranë (Janar – Dhjetor 2017); për Zyrën Vendore Krujë (Prill-Dhjetor 2017) dhe për Zyrat Rajonale Fier dhe Gjirokastrë (Korrik - Dhjetor 2017).
2. Sondazhe të drejtëpërdrejta të ADISA, FO-Tiranë, në total 158 pyetësor deri në dhjetor 2017.
3. Raport mujor të performancës për 12 Institucione (ZOS).
4. Pyetësor për institucionet që raportojnë në ZOS, 1065 në total (institucionet ATP; SHKP, ISSH, QKB, FSDKSH, DPSHTRR, DPT)
5. Pyetësor vetëvlerësimi për stafin në Zyrën Vendore Kavajë (10 punonjës) dhe Zyrën Rajonale Tiranë (18 punonjës).
6. Është matur kënaqësia e qytetarit në Zyrën Vendore Kavajë në total me 492 pyetësor (në muajin Janar dhe Mars) dhe në Zyrën Rajonale Tiranë me 156 pyetësor (në muajin Shkurt).
7. Është matur kënaqësia e qytetarit në Zyrën Rajonale Fier nëpërmjet 30 telefonatave (Nëntor-Dhjetor)

Produkti G: Janë realizuar trajnime të vazhdueshme për secilin sektor në ADISA si dhe për punonjësit e Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike në qytetin e Kavajës, Krujës, Fierit dhe Gjirokastrës. Janë zhvilluar në total 57 tema trajnime, me 158 punonjës pjesëmarrës. Për aktivitetin e dytë të këtij produkti (Rritja e kapaciteteve në mallra) kanë përfunduar të gjitha procedurat e prokurimit dhe janë marrë në dorëzim produktet/mallrat.

Produkti H: Është bërë promovimi nëpërmjet disa kanaleve promovuese: Fushatë sensibilizimi “Java e Inovacionit”, Facebook, Twitter, Instagram, Youtube, Web page (100% i përditësuar), TV, etj. Ka filluar funksionimi i Call Center 11-800 në fillim të muajit tetor 2016 dhe është realizuar fushata promovuese (spotet në TV, Radio, Fb, etj).

- Intervistë në Scan TV, flet Znj. Edlira Cimbi Drejtoreshë e Administrimit të Brendshëm – Prill 2017
- Intervistë në Scan TV – Maj 2017
- Znj. Anisa Gjika në vizion plus “7 pa pesë” – Nëntor 2017
- Znj. Anisa Gjika në Scan TV “Për të fol” – Nëntor 2017

Janë shpërndarë dhe vendosur postera promovues në Institucione publike në Shqipëri dhe janë realizuar open day për promovimin e ADISA-ës në qytetin e Kavajës dhe Fierit. Janë realizuar intervista direkt me qytetarët në qytetin e Kavajës.

Janë zhvilluar konferenca për ofrimin e shërbimeve publike brenda dhe jashtë vendit.

Gjithashtu nga Sektori i Marketingut dhe Komunikimit janë realizuar disa aktivitete:

- a) Ceremonia përruese për hapjen e zyrës të “Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në Gjirokastrë – Nëntor 2017
- b) Përrurimi i projektit “Mbështetje për përrmirësimin e ofrimit ë shërbimeve publike me në qendër qytetarin” IPSD – Nëntor 2017
- c) Takim me anëtarët e Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese - Shkurt 2017
- d) Konferenca Rajonale për Shërbimet Publike RESPA (Public Service delivery across the Western Ballkans) – Maj 2017
- e) Vizitë e përfaqësuesve të Bashkimit European dhe të COWEB në ADISA – Prill 2017
- f) ReSPA Annual Conference Innovation in Public Administration - Navigating in Times of Change – Tetor 2017
- g) Istanbul Innovation Day – Nëntor 2017
- h) Edicioni i 4-t i Forumit mbi Qeverisjen me temë “Progresi në arritjen e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm” nga Moldova Innovation Lab – Nëntor 2017
- i) Konferenca e gjashtë vjetore me temë: "Trajnim i mirë - menaxhim më i mirë", organizuar nga Agjencia e Shërbimit Civil, Federata e Bosnje Hercegovinës me seli në Sarajevë – Nëntor 2017
- j) ADISA dhe Moldova eGovernment Center shkëmbim eksperiencash në Tiranë - Dhjetor 2017
- k) Aktiviteti përrmbyllës: “Mbështetje për Masat Anti-Korrupsion në Shqipëri” nga OSBE – Dhjetor 2017
- l) Shpallja e konkursit për aplikacionin ADISA MOBILE APP – Mars 2017
- m) Sensibilizim për njerëzit në nevojë – Dhjetor 2017

Produkti J: Nga të dhënat e marra nga Institucionet Qendrore dhe kartelat informative për secilin shërbim është ndërtuar një databazë nga Sektori i Informacionit, pranë ADISA. Masa e realizimit të kësaj databazë është 100%. Përrditësimi i saj me shtimin e shërbimeve të reja është proces i vazhdueshëm

Produkti J: Ka përrfunduar procesi i prokurimit për fushatën e ndërgjegjësimit. Është kontraktuar kompania fituese dhe është lidhur kontrata me objekt “Brand Application and Communications”. Fushata filloi me realizimin e spotit promovues të Call Center (numri 118-00) në muajin Shtator 2016, për të vijuar më tej me fushatën promovuese për hapjen e Qendrës të Integruar Kavajë, Krujë, Fier dhe Gjirokastrë si dhe me sportelet pritëse të ZVRPP Tiranë. Në muajt Korrik dhe Gusht 2017 janë realizuar edhe 2 spote të reja (një për promovimin e call center dhe një për marrjen e opinionit të qytetarëve). Kjo fushatë ka përrfunduar.